

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
viti 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	30.12.2024	Në zbatim të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si gazetar i emisionit investigative, ju lutem që të më vini në dispozicion vendimet përfundimtare për gratë e mëposhtme, të cilat janë dënuar për veprat penale të listuara: 1. D. D – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” 2. E. Xh – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim. 3. H. H – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” kryer në bashkëpunim. 4. M. C – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” 5. M. M – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”	10.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 249091 Prot., datë 30.12.2024, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale të anonimizuar për të pandehurit shtetasit me initiale R. K, D. D, K. P, L. Q, A. P dhe M. P.	E plotë	Nuk ka

¹Numrarendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		6. M. B – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” 7. N. D – “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” 8. O. G – “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese.” 9. R. K – “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese,” mbetur në tentativë, dhe “Shkatërrimi i pronës me zjarr”. 10. A. N dhe A. P				
2	09.01.2025	Redaksia Medias në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkoj nga ana juaj, informacion lidhur me shtetasit, Sh. K dhe P. P, të arrestuar nga Drejtoria e Policisë Fier në dhjetor të vitit 2023, si të dyshuar për veprat penale, "Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës", "Trafikimi i armëve dhe municionit luftarak" dhe "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", të kryera në bashkëpunim, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për: 1. Në çfarë faze është procesi i gjykimit të këtij rasti në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm? 2. Na vendosni në dispozicion të gjitha vendimet e marra për këtë rast deri më tani.	17.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, datë 09.01.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me nr. 366 Prot., datë 10.01.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar dhe e gjykuar çështja penale me kërkues Sh. K dhe palë e interesuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt “Humbjen e fuqisë së paraburgimit, vendosur me vendimin	E plotë	Nuk ka

			<i>nr.1806 Regj. Themeltar, datë 21.12.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.</i> Në përfundim, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin datë 15.01.2025 ka vendosur: <i>“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1973, datë 19.12.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.</i> -Rezulton e regjistruar dhe e gjykuar çështja penale me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe persona nën hetim shtetasit me initiale Sh. K dhe P.P, me objekt <i>“Zgjatje e afateve te paraburgimit”.</i> Në përfundim, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin datë 15.01.2025 ka vendosur: <i>“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1957, datë 17.12.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë</i>		
--	--	--	---	--	--

			të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”. -Rezulton e regjistruar dhe e gjykuar çështja penale me të arrestuar shtetasit me iniciale Sh. K dhe P. P dhe kërkuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt “Vlerësimin si të ligjshëm të “arrestit në flagrancë” të personave nën hetim, dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 138/2, 283/1 dhe 278/3 të Kodit Penal. Caktimin ndaj tyre të masave të sigurimit persona”. Në përfundim, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin datë 15.01.2025 ka vendosur: “Miratimin e vendimit datë 21.12.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”. Ju bëjmë me dije se, vendimin (masë sigurimi), nuk mund ta vëmë në		
--	--	--	--	--	--

				dispozicion, pasi i përket fazës së hetimeve paraprake.		
3	16.01.2025	Ky komunikim vjen në kuadër të një raporti që po përgatitet për Agjencinë e Bashkimit European për të Drejtat Themelore (FRA), i cili ka si qëllim përditësimin e të dhënave mbi urrejtjen dhe diskriminimin anti-mysliman në Shqipëri. Ju lutemi gjeni bashkëngjitur një letër mbështetëse nga FRA që konfirmon rëndësinë e këtij projekti. Në këtë kontekst, ju lutemi të vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm: 1. Listë të çështjeve të depozituara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës 1 janar 2023 – 31 dhjetor 2024 që lidhen me urrejtjen ose diskriminimin anti-mysliman. 2. Të dhëna mbi ecurinë e këtyre çështjeve, përfshirë vendimet e marra dhe rezultatet përfundimtare. 3. Për vendimet që janë publike, ju lutemi të na ofroni lidhjet (link) përkatëse. Informacioni juaj do të reflektohet në raportin përfundimtar të FRA, duke ndihmuar në përmirësimin e të kuptuarit dhe adresimin e kësaj problematike në nivel kombëtar dhe europian.	30.01.2025	Në përgjigje të kërkesës për informacion paraqitur në formë elektronike me e-mail, datë 16.01.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me nr. 809 Prot, datë 16.01.2025, Ju bëjmë me dije se nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk rezulton e ardhur dhe e gjykuar asnjë çështje gjyqësore që lidhet me "<i>arëjtjen ose diskriminimin anti-mysliman</i>".	E plotë	Nuk ka

4	14.01.2025	Organizata jo partiake dhe jofitimprurëse SCIDEV në bashkëpunim me Safe Journalists Network, është duke përgatitur rapordin vjetor të Gazetarëve të sigurt i cili përmbledh të dhëna zyrtare mbi sulmet apo kërcënimet e bëra ndaj gazetarëve për vitin 2024. Në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkojmë informacion mbi rastet mbi si në vijim për periudhën kohore 1 Janar 2024- 31 Dhjetor 2024. 1. <i>“Statistika për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 617 të Kodit Civil”</i> 2. <i>Statistika për numrin e çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 119 të Kodit Penal “Fyerja”, neni 120 të Kodit Penal “Shpifja”, neni 121 të Kodit Penal “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”, neni 143/b “Mashtrimi Kompjuterik” dhe neni 186/a të Kodit Penal “Falsifikimi Kompjuterik”.</i> 3. <i>Si kanë ndryshuar statistikat e vitit 2024 në raport me vitin 2023, lidhur me këto çështje?</i>	04.02.2025 5	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe protokolluar prej tyre me numër 123/1 Prot., datë 15.01.2025, regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 957, datë 20.01.2025, me anë të së cilës kërkohet informacion, ju bëjmë me dije se: Në lidhje me pyetjen e parë: <i>“Për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 617 të Kodit Civil “Publikimet mashtruese ose të pasakta”, neni 625 të Kodit Civil “Përgjegjësia për dëmin jo pasuror” dhe neni 647/a të Kodit Civil “Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jo pasuror”.</i> Ju informojmë se, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm: Rezultojnë të regjistruara dhe të pa gjykuara 5 (pesë) çështje civile, me bazë ligjore nenin	E plotë	Nuk ka

		4. “Vendimmarrja përkatëse për këto çështje, vendime dënimi, pafajësie, pushimi, pranimi apo rrëzim padie”. 5. “Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura”. 6. Nëse ka të ndërtuar një regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave, ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre?	625 të Kodit Civil “Përgjegjësia për dëmin jo pasuror”. Rezultojnë të regjistruara dhe të pa gjykuara 8 (tetë) çështje civile, me bazë ligjore nenin 647/a të Kodit Civil “Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jo pasuror”. Rezultojnë të regjistruara dhe të pa gjykuara 2 (dy) çështje civile, me bazë ligjore nenin 617 të Kodit Civil “Publikimet mashtruese ose të pasakta”. Në lidhje me pyetjen e dytë: “Për numrin e çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 119 të Kodit Penal “Fyerja”, neni 120 të Kodit Penal “Shpifja”, neni 121 të Kodit Penal “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”, neni 143/b “Mashtrimi Kompjuterik” dhe neni 186/a të Kodit Penal “Falsifikimi Kompjuterik”. Ju informojmë se, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rezultojnë:		
--	--	---	--	--	--

				Rezulton e regjistruar dhe e pa gjykuar 2 (dy) çështje penale, me bazë ligjore nenin 121 të Kodit Penal <i>“Ndërhyrje të padrejta në jetën private”</i>. Rezultojnë të regjistruara dhe të pa gjykuara 7 (shtatë) çështje penale, me bazë ligjore nenin 119 të Kodit Penal <i>“Fyerja”</i>. Rezultojnë të regjistruara dhe të pa gjykuara 14 (katërmbëdhjetë) çështje penale, me bazë ligjore nenin 120 të Kodit Penal <i>“Shpifja”</i>. Në lidhje me pyetjen e tretë: <i>“Si kanë ndryshuar statistikat e vitit 2024 në raport me vitin 2023, lidhur me këto çështje?”</i> Në raport me vitin 2023, numri i çështjeve të regjistruara për vitin 2024 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është më i ulët. Në lidhje me pyetjen e katërt: <i>“Vendimmarrja përkatëse për këto çështje, vendime dënimi, pafajësie, pushimi, pranimi apo rrëzim padie?”</i> Për vitin 2024, nuk rezulton asnjë çështje civile dhe penale e gjykuar dhe e përfunduar. Në lidhje me pyetjen e pestë: <i>“Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura?”</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				Për vitin 2024, rezultojnë të regjistruara 38 çështje me palë gazetar/punonjës të medias, nga të cilat 23 janë me karakter penal dhe 15 me karakter civil. Të mbartura nga viti 2023, rezultojnë afërsisht 42 çështje të karakterit civil dhe penal. Në lidhje me pyetjen e gjashtë: <i>“Nëse ka të ndërtuar një regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave, ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre?</i> -Ju informojmë se, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk disponon një regjistër ku të regjistrohen rastet e padive mbi gazetarët dhe punonjësit e medias.		
5	21.01.2025	Gazetaria e Tv në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, kërkoj nga ana juaj, informacion si më poshtë: 1. Sa shtetast janë dënuar me “punë me interes publik” nga viti 2020-31 dhjetor 2024 (të dhënat të paraqiten sipas gjykatave në Republikën e Shqipërisë”. 2. Sa zyrtarë janë dënuar me “punë me interes publik” nga gjykata e posaçme e shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar/gjykata e posaçme e apelit (nga viti 2020 deri në dhjetor 2024).	06.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe protokolluar prej tyre me numër 256/1 Prot., datë 21.01.2025 e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.1637 Prot., datë 27.01.2025, me të cilën kërkohet informacion lidhur me numrin shtetasve të dënuar me “punë në interes publik” për periudhën 01.01.2020-	E plotë	Nuk ka

		3. Për cfarë veprash penale janë dënuar shtetasit shqiptarë (pika 1) zyrtarët (pika 2).		31.12.2024, nga verifikimi i kryer në kodekset e vendimeve penale pranë Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rezulton se: Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 17 shtetas, për veprat penale: - “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” neni 190 K. Penal - “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal - “Moskallëzim krimi” neni 300 K. Penal - “Veprime që pengojnë zbulimi e të vërtetës” neni 301 K. Penal - “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, neni 278K.Penal - “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike” neni 137/1 K. Penal	
--	--	--	--	---	--

				- <i>“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal</i> - <i>“Dhuna në familje” neni 130/a K. Penal</i> Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Durrës, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 10 shtetas, për veprat penale: - <i>“Dhuna në familje” neni 130/a K. Penal</i> - <i>“Moskallëzim krimi” neni 300 K. Penal</i> - <i>“Ushtrim i ndikimit të ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” të kryer në bashkëpunim neni 245/1 , parag.2 dhe 25 K. Penal</i> - <i>“Fyerja e gjyqtarit” neni 318 K. Penal</i> - <i>“Falsifikimi i dokumenteve” në bashkëpunim neni 186/3 K. Penal</i> Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër, në aplikim të nenit 63 të Kodit	
--	--	--	--	---	--

				Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 11 shtetas, për veprat penale: - “Prodhimi i kundërligjshëm i mallrave dhe artikujve industrial dhe ushqimorë” neni 288/a/1 K. Penal - “Fshehja e të ardhurave”, neni 180/1 K. Penal - “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” neni 289/1 K. Penal - Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” neni 178/2 K. Penal - “Ushtrim i ndikimit të ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” neni 245/1/2 K. Penal - “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike” neni 137/1 K. Penal - “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal - Plagosje e lehtë me dashje e kryer në		
--	--	--	--	---	--	--

				<i>bashkëpunim neni 89, 25 K. Penal</i> - <i>“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal</i> Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 6 shtetas, për veprat penale: - <i>“Moskallëzim krimi” neni 300 K. Penal</i> - <i>“Vetëgjyqësi” neni 277 K. Penal</i> - <i>“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” neni 190 K. Penal</i> - <i>“Mbajtja pa leje, prodhimi armëve shpërthyes dhe municionit” neni 278/2 K. Penal</i> Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Vlorë, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, është dënuar me “punë në interes publik” 1 shtetas, për veprën penale:		
--	--	--	--	---	--	--

				- “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Korçë nuk është dënuar me “punë në interes publik” asnjë shtetas. Për periudhën 01.02.2023 – 31.12.2024, me vendim të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë dënuar me “punë në interes publik” 22 shtetas, për veprat penale: - “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” neni 290/2 K. Penal - “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal - “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo të vizave” neni 189/2 K. Penal - “Falsifikimi i dokumenteve” neni 186/2 K. Penal - “Falsifikim i dokumenteve	
--	--	--	--	---	--

				<i>shëndetësore” 188/1 K. Penal</i> - <i>“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal</i> - <i>“Mjekim i pakujdesshëm” neni 96/1 K. Penal</i> - <i>“Kundërshtim të punonjësit të policisë” neni 236/2 K. Penal</i> - <i>“Largim nga vendi i aksidentit” neni 273 K. Penal</i> - <i>“Mashttrim ne sigurime” neni 145 K. Penal</i> - <i>“Ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” neni 245/1 K. Penal</i> - <i>“Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” neni 289/1 K. Penal</i> - <i>“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura mbetur në tentativë” neni 101/2-22 K. Penal</i> - <i>“Dhuna në familje” neni 130/a K. Penal</i> Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal janë dënuar me “punë në interes publik”, gjithsej 66 shtetas.		
--	--	--	--	--	--	--

6	29.01.2025	Në kuadër të zhvillimit të një punimi, jam e interesuar të njihem me praktikën gjyqësore lidhur me interpretimin që seksioni penal i gjykatës ka bërë lidhur me afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, pra për rastet kur personi nën hetim akuzohet në të njëjtin procedim për dy ose më shumë vepra penale, kur secila prej tyre ka një dënim në maksimum jo më shumë se 10 vjet burgim. Në kushtet kur e kam të pamundur ta siguroj këtë informacion përmes faqes zyrtare të internetit, sikurse është e mundur me vendimet e Gjykatës së Lartë, në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, lutem vënien në dispozicion të të paktën 5 vendimeve të gjykatës që lidhen me interpretimin e dispozitës së lartpërmendur, duke siguruar anonimizimin e tyre dhe mos cenimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Lutem përcjelljen e informacionit në rrugë elektronike, në të njëjtën adresë emaili që dërgohet dhe kërkesa. Bashkëlidhur gjendet dhe karta e ID, sikurse kërkohet. Faleminderit paraprakisht për bashkëpunimin tuaj.	12.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 1993 Prot., datë 29.01.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale sipas informacionit të kërkuar	E plotë	Nuk ka
		Autore e emisionit “.....”, ne ABC News. Me duhen dy vendime te Gjykares se		Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail,		

7	03.02.2025	Apelit te Vlores per nje teme qe jam duke punuar. Vendimi i Gjykates se Apelit Vlore nr.402, date 13.11.2013 dhe vendimi i te njejtës Gjykate nr. 39, date 10.07.2019 Te akuzuarit ne keto procese: O. B dhe L. H	06.02.2025	protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 2389 Prot., datë 03.02.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale të anonimizuar për të pandehurit O. B dhe L. H.	E plotë	Nuk ka
8	17.02.2025	Në zbatim te Ligjit nr. 119/2014, kërkoj informacion sa është numri i çështjeve me objekt “dëmshtëpërblimin e demit”, per konstatimi te cënimit te se drejtës per nje proces te rregullt gjyqësor, ne zbatim te nenit 399/6. Nese është e mundur datën e regjistrimit ne Gjykatën e Apelit te Juridiksionit te Përgjithshëm dhe sa prej çështjeve janë gjykuar dhe sa janë ne pritje per gjykim.	03.03.2025	Nepermjet kerkesës suaj drejtuar Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Përgjithshëm, keni kerkuar informacion lidhur me numrin e ceshtjeve te regjistruara dhe te gjykuara prane kësaj Gjykate, per kerkesat me objekt: "Konstatimi i cënimit te se drejtes per nje proces te rregullt gjyqësor", iu bejme me dije se : Nga verifikimet e kryera ne sistemin elektronik te regjistrimit te ceshtjeve, prane Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Përgjithshëm, jane rregjistruar dhe shyrtuar kerkesa me objektin e kerkuar, si me poshte vijon: 1. Per vitin 2022 është regjistruar 1 (nje) ceshtje, e cila është shqyrtuar ne vitin 2022; 2. Per vitin 2023, jane rregjistruar 5 (pese) ceshtje, nga te cilat 2 (dy) ceshtje jane shqyrtuar ne vitin 2023, 2 (dy) ceshtje jane shqyrtuar ne vitin	E plotë	Nuk ka

				2024 dhe 1 (nje) çështje eshte ende ne pritje per gjykim; 3. Per vitin 2024, jane regjistruar 20 (njetzet) ceshtje, nga te cilat 15 (pesembedhjet) ceshtje janë shqyrtuar ne vitin 2024, 3 (tre) çështje janë shqyrtuar ne vitin 2025 dhe 2 (dy) ceshtje jane ende ne pritje per gjykim; 4. Per vitin 2025, jane regjistruar 3 (tre) ceshtje, te cilat nuk jane planifikuar per gjykim.		
9	24.02.2025	Televizioni kërkon vënien në dispozicion nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vendimin penal ndaj shtetasit me initiale A. I.	05.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 4201 Prot., datë 24.02.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimin penale të anonimizuar për shtetasin A. I.	E plotë	Nuk ka
10	05.03.2025	Kerkesa ime per informacion eshte per ankimet e regjistruara ne Gjykatën e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem per ceshjet gjyqesore qe kane per objekt "shperblimin e demit" per rastet kur eshte konstatuar shkelja e se drejtes per nje proces te rregullt gjyqesor. Ku Gjykata e Shkalles se Pare ka marre nje vendim per shperblimin e demit ku te paditur jane thirrur Ministria e Financave	21.03.2025	Ne pergigje te kerkeses tuaj derguar me e-mail date 05.03.2025, e cila eshte regjistruar prane Zyres se Protokollit te Gjykatës së Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem me nr. 5121 Prot., date 05.03.2025, ku kerkoni informacion per ankimet e regjistruara, per ceshtjet gjyqesore qe kane per objekt "shperblim demi" per rastet kur eshte konstatuar shkelja e se	E plotë	Nuk ka

		dhe Ministria e Drejtësisë dhe palet ndergyqese e kanë ankimuar vendimin.		drejtes per një proces te rregullt gjyqësor. Ju informojme se nga verifikimi i bere ne sistemin ICMIS prane Gjykatës se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, jane rregjistruar dhe shyrtuar, kerkesat sipas objektit te kerkuar, si me poshte: 1. Per vitin 2018 jane rregjistruar 2 (dy) ceshtje, te cilat jane ne pritje per gjykim. 2.Per vitin 2020 eshte rregjistruar 1 (nje) ceshtje, e cila eshte ne pritje per gjykim. 3. Per vitin 2022 jane rregjistruar 2 (dy) ceshtje, e cila eshte gjykuar ne vitin 2024, ndersa tjetra është ne pritje per gjykim. 4. Per vitin 2023 eshte rregjistruar 1 (nje) ceshtje, e cila eshte gjykuar ne vitin 2024. 5.Per vitin 2024 jane rregjistruar 2 (dy) ceshje, e cila nje eshte planifikuar per gjykim, ndërsa tjetra eshte ne pritje per gjykim.		
11	06.03.2025	Në zbatim të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si gazetar i emisionit investigative, ju lutem që të më vini në	12.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 5254 Prot., datë 06.03.2025, bashkëlidhur,	E plotë	Nuk ka

		dispozicion vendimin përfundimtar ndaj shtetasit E. P etj.		ju dërgojmë vendimin penale të anonimizuar për shtetasin E. P etj		
12	10.03.2025	Ne baze te ligjit 119/2014 “Per te drejtën e informimit”, kerkoje nje kopje te vendimit date 24.02.2025, te anonimizuar. Nuk cenoje asnjë te dhene, ne respektim te ligjit.	17.03.2025	Ne pergjigje te emailit Tuaj, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 5598 Prot., datë 10.03.2025, ku kerkoni te anonimizuar vendimin date 24.02.2025, ju bejme me dije se nga verifikimi i kryer vendimi nuk eshte dorezuar ne k/sekretari	E plotë	Nuk ka
13	11.03.2025	Në zbatim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si gazetar i televizionit, ju lutem që të më vini në dispozicion vendimin përfundimtar ndaj shtetasit A. S dhe S. S.	17.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 5710 Prot., datë 11.03.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimin penale të anonimizuar për shtetasin A. S dhe S. S.	E plotë	Nuk ka
14	11.03.2025	Në zbatim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si studente në Fakultetin e Drejtësisë, duke qene se jam duke punuar per temen e diplomes, kerkoje nga ana Juaj informacion statikor per peridhen 2023-2025 lidhur me çështjet civile me objekt ‘Marrëdhënie pune’ që janë regjistruar dhe gjykuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku punemarres eshte	17.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 11.03.2025 e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.5882 Prot., datë 13.03.2025, me të cilën kerkoni informacion lidhur me çështjet civile me objekt ‘Marrëdhënie pune’ që janë regjistruar dhe gjykuar në Gjykatën e Apelit të	E plotë	Nuk ka

		individ, shoqëri shtet. Konkretisht sa çështje janë te fituara apo te humbura perballe shtetit duke e marre kete statistike per nje periudhe 2 vjecare.		Juridiksionit të Përgjithshëm, për periudhën 2023-2025. Ju informojmë se, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , për vitin 2023 janë gjykuar 187 çështje civile me objekt ‘Marrëdhënie pune’, ku: -Është vendosur ”lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë institucion gjithsej 78 çështje. -Është vendosur ”lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 39 çështje. -Është vendosur ”ndryshimi i vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë institucion gjithsej 40 çështje . -Është vendosur ” ndryshimi i vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 19 çështje. -Është vendosur ”pushimi i çështjes civile”, ku palë ka qenë Institucion gjithsej 5 çështje. -Është vendosur ”pushimi i çështjes civile”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 1 çështje. -Është vendosur ” prishja e vendimit të shkallës së parë”,	
--	--	--	--	---	--

			ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 5 çështje. Ju informojmë se, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , për vitin 2024 janë gjykuar 194 çështje civile me objekt ‘Marrëdhënie pune’, ku: -Është vendosur ”lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë institucion gjithsej 83 çështje . -Është vendosur ”lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 48 çështje. -Është vendosur ”ndryshimi i vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë institucion gjithsej 17 çështje. -Është vendosur ” ndryshimi i vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 22 çështje. -Është vendosur ”pushimi i çështjes civile”, ku palë ka qenë institucion gjithsej 6 çështje. -Është vendosur ”pushimi i çështjes civile”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 12 çështje. -Është vendosur ” prishja e vendimit të shkallës së parë”,		
--	--	--	--	--	--

				ku palë ka qenë institucion gjithsej 4 çështje. -Është vendosur ” prishja e vendimit të shkallës së parë”, ku palë ka qenë shoqëri gjithsej 2 çështje.		
15	28.03.2025	Në zbatim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si gazetar i emisionit investigative., kerkoje informacion ne lidhje me shtetasin me initiale E. M.	11.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 28.03.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 7145 Prot., datë 28.03.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja penale me nr. ... Akti, nr. ... sistemi, datë 05.06.2023 regjistrimi, me palë: KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë I AKUZUAR : E. M AKUZUAR:Për veprën penale te "Drejtimi i automjeteve ne mënyre te parregullt" i parashikuar nga neni 291 i K.Pr.Penale dhe për veprën penale te "Largim nga vendi i aksidentit" parashikuar nga neni 273 I K. Penal. Në short elektronik kjo dosje i ka rënë për gjykim relator gjyqtar Ardit Mustafaj dhe seanca për gjykimin e çështjes	E plotë	Nuk ka

				është caktuar në datën 19.06.2025, ora 13:00		
16	28.03.2025	Qendra Psiko-Sociale "Vatra" është një organizatë shqiptare jofitimprurëse, e cila ofron shërbime dhe ekspertizë për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje e shoqëri. Qendra Psiko-Sociale "Vatra" ka filluar aktivitetin e saj si organizatë qysh prej vitit 1999. Është e regjistruar si një organizatë jofitimprurëse, fillimisht pranë Gjykatës së rrethit Vlorë me vendim 095, dt. 02.10.2001 dhe më vonë e reregjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr. Akti 211, datë 17.01.2005. Qendra Psiko-Sociale "Vatra" ka si mision parandalimin e trafikimit njerëzor, dhunës në familje dhe me bazë gjinore, mbrojtjen dhe fuqizimin social dhe ekonomik të viktimave të këtyre fenomeneve në Shqipëri nëpërmjet informimit, edukimit, advokimit dhe shërbimeve sociale rezidenciale dhe komunitare. Qendra Psiko Sociale "Vatra" po zbaton projektin rajonal me titull: SPOT ON/ "Përgjegjësia shtetërore për ndërkimimin e trafikimit të qënieve njerëzore", mbështetur nga SMART BALKANS me fonde të Ministrisë së Jashtme të Norvegjisë. Një nga objektivat e projektit është të monitorojë organet ligjzbatuese në lidhje me veprat penale të trafikimit të	30.05.2025	Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 527 Prot., datë 26.03.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 7099 Prot., datë 28.03.2025, ju informojmë se nga verifikimet e kryera në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, për vitin 2024, rezultojnë të regjistruara çështjet penale si më poshtë: -Për veprën penale <i>"Trafikimin e personave të rritur"</i>, të parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, nuk rezulton çështje penale e regjistruar dhe e gjykuar, në vitit 2024. - Për veprën penale <i>"Trafikimin i të miturve"</i>, të parashikuar nga neni 128/b të Kodit Penal, nuk rezulton çështje penale e regjistruar dhe e gjykuar, në vitin 2024. - Për veprën penale <i>"Shfrytëzim prostitucioni"</i>, të parashikuar nga neni 114 të Kodit Penal, rezultojnë të regjistruara 4 (katër) çështje te cilat 2 (dy) janë gjykuar dhe 2 (dy) janë në pritje për tu	E plotë	Nuk ka

	personave të rritur, trafikimin e të miturve, në rastet kur veprat penale janë kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. GENDRA PSIKO-SOCIALE "VATRA" Një nga objektivat e projektit është të monitorojë organet ligjzbatuese në lidhje me veprat penale të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimin e të miturve. Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti është planifikuar të kryhet një analizë e vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt "Trafikimin e personave të rritur" parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, "Trafikimin e të Miturve", parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, dhe veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, për gjatë vitit 2024. Duke qenë se gjykata juaj është kompetente për gjykimin e veprave penale të sipërpërmendura bazuar në nenet 74 të Kodit të Procedurës Penale, për qëllime të studimit kërkojmë nga ju informacionin si më poshtë: 1)Sa është numri i procedimeve të regjistruara në gjykatën tuaj për çështjet me këtë objekt, të ndarë sipas objektit gjatë vitit 2024; 2)Lutemi do ta vlerësonim shumë bashkëpunimin tuaj, nëpërmjet vënies në		gjykuar. Vendimet e arsyetuara nuk janë dorëzuar akoma në K/Sekretari		
--	--	--	--	--	--

		dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me veprat penale të parashikuara në Seksionin VII të Kodit Penal, "Vepra Penale kundër Lirisë së Personit", Seksionin VIII "Vepra Penale kundër Moralit dhe Dinjitetit dhe Seksionin IX "Vepra Penale kundër Fëmijëve, Martesës dhe Familjes", parashikuar në nenet 110/a, 114 dhe 128/b të Kodit Penal, për gjatë vitit 2024; 3) Lutemi na dërgoni një informacion në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë; Sa më sipër, Qendra Psiko Sociale "Vatra" do të vlerësonte ofrimin e informacionit të ndarë sipas pikave të sipërpërmendura, brenda afateve ligjore të parashikuar në ligjin 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit". Gjithashtu, Qendra Psiko Sociale "Vatra", garanton se të dhënat e vendimeve do të trajtohen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Gjetjet dhe rekomandimet do të kenë qëllime studimore dhe do të ndahen me profesionistë të sistemit të drejtësisë, me qëllim përmirësimin e zbatimit të legjislacionit kundër trafikimit të qenieve njerëzore.				
		Për t'i ardhur në ndihmë informacionit të saktë publik, në bazë të ligjit nr.119/2014		Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 01.04.2025, protokolluar pranë		

17	01.04.2025	neni 15 pika 1 dhe 2 (Për të Drejtën e Informimit) dhe Kushtetutës, redaksia e emisionit “F.. F...” në televizionin “Top Channel”, kërkon nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, informacion ose dokumente për masën e siguresë (mars 2025) ndaj 4 personave (F. Sh, B. Sh, Sh. H dhe I. I), të akuzuar për vrasjen e ndodhur në datën 31.03.2024. 1. Çfarë mase sigurie është dhënë në muajin mars të vitit 2025 ndaj F. Sh, B Sh, Sh. H dhe I. I? 2. A mund të na vini në dispozicion dispozitivin, vendimin, e kësaj mase sigurie? 3. Çfarë dispozitash ligjore janë përdorur për të liruar këta persona (të miturit)? Çfarë dispozite ligjore është përdorur për të mos liruar personin mbi 18 vjeç? 4. Cili gjyqtar/e (ose trup gjykues) ka dhënë këtë vendim?	15.04.2025	Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 7309 Prot., datë 01.04.2025, me anë të së cilës kërkohet informacion, ju bëjmë me dije se: Në lidhje me pyetjen e parë: <i>“Çfarë mase sigurie është dhënë në muajin Mars të vitit 2025 ndaj F. Sh, B. Sh, Sh. H dhe I. I?”</i> Nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, Ju bëjmë me dije se, në muajin Mars të vitit 2025, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , është regjistruar ankimi ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i të miturve në konflikt me ligjin me initiale B. Sh, Sh.H dhe I. I, me objekt <i>“Konstatimi i humbjes të afateve të paraburgimit”</i>, të gjykimit në themel të akuzës së ngritur ndaj tyre, duke u pretenduar tejkalimi i këtyre afateve, ku brenda (6 muajve) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duhet të jepte vendim dënimi. Ndaj shtetasit me initiale F. Sh, nuk rezulton të ketë të ketë të	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

				regjistruar çështje me objektin e lartpërmendur. Në lidhje me pyetjen e dytë: “<i>A mund të na vini në dispozicion diapozitivin, vendimin e kësaj mase sigurimi?</i>” Në datë 25.03.2025, në përfundim të shqyrtimit të ankimeve të bëra nga të miturit në konflikt me ligjin me iniciale B. Sh, Sh.H dhe I. I, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur: 1. Ndryshimin e vendimit Nr.496 Rregj, dt.19.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë: -Pranimin e kërkesës së të miturit në konflikt me ligjin B. Sh. -Kostatimin e humbjes së afateve të paraburgimit, të masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar me vendimin Nr.869 Rregj, dt.04.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. -Caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin B. Sh “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga Neni 237 i Kodit Penal duke urdhëruar të miturin në konflikt me ligjin B.		
--	--	--	--	--	--	--

				Sh të mos largohet nga banesa ndodhur në adresën: ..., Tiranë. - Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore me ekzekutimin e këtij vendimi. - Urdhërohet lirimi i menjëhershëm nga paraburgimi i të miturit në konflikt me ligjin B. Sh nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor. - Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë 2. Ndryshimin e vendimit Nr.505 Rregj, dt.19.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë: -Pranimin e kërkesës së të miturit në konflikt me ligjin Sh. H. -Kostatimin e humbjes së afateve të paraburgimit, të masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar me vendimin Nr.869 Rregj, dt.04.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. -Caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin Sh. H “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal duke urdhëruar të miturin në konflikt me ligjin Sh. H të mos largohet nga		
--	--	--	--	---	--	--

				banesa ndodhur në adresën:, Tiranë. - Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore me ekzekutimin e këtij vendimi. - Urdhërohet lrimi i menjëhershëm nga paraburgimi i të miturit në konflikt me ligjin Sh. H nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor. - Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. 3. -Ndryshimin e vendimit Nr.519 Rregj, dt.19.02.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë: -Pranimin e kërkesës së të miturit në konflikt me ligjin I. I. -Kostatimin e humbjes së afateve të paraburgimit, të masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar me vendimin Nr.869, Rregj, dt.04.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, -Caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin I. I “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal duke urdhëruar të miturin në konflikt me ligjin I. I të mos largohet nga banesa		
--	--	--	--	--	--	--

				ndodhur në adresën:, Tiranë. - Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore me ekzekutimin e këtij vendimi. - Urdhërohet lirimi i menjëhershëm nga paraburgimi i të miturit në konflikt me ligjin I. I nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor . - Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me pyetjen e tretë: <i>“Çfarë dispozitash ligjore janë përdorur për të liruar këta persona (të mitur). Çfarë dispozite ligjore është përdorur për të mos liruar personin mbi 18 vjeç?”</i> Dispozitat ligjore që janë përdorur për ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në atë të “arrest në shtëpi”, janë neni 263 pika 2, shkronja “c” të K.Pr.Penale <i>“Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”</i> i cili parashikon: <i>“..2. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë: a- një muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale; b- tre</i>	
--	--	--	--	--	--

				muaj, kur procedohet për krim; c- gjashtë muaj, kur procedohet për krime të organizuara dhe të kryera nga banda” dhe Nenin 87 të ligjit Nr.37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM) ku parashikohet se :.. 3. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale zbatohen për aq sa është e mundur për paraburgimin ndaj të miturit në konflikt me ligjin. 4. Pavarësisht nga parashikimi i bërë në pikën 3, të këtij Neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës së paraburgimit të caktuar për të rriturin, sipas Kodit të Procedurës Penale. dhe Nenin 88 pika 3 ku parashikohet se : ...Gjykata e shkallës së parë përfundon shqyrtimin e çështjes në një kohë sa më të shpejtë, por jo më vonë se 6 muaj nga data e depozitimit të akteve në gjykatë. Për shtetasin me initiale F. Sh, i cili është mbi moshën 18 vjeç, nuk rezulton të jetë regjistruar çështje me objektin e lartpërmendur. Në lidhje me pyetjen e katërt: “Cili gjyqtar/e (ose trup gjykues) ka dhënë këtë vendim?”		
--	--	--	--	---	--	--

				Trupi gjykues është përbërë me relatores gjyqtare Miranda Andoni dhe anëtarë gjyqtar Qemal Zaimi dhe gjyqtar Ardit Mustafaj. Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të anonimizuar të vendimeve: -Vendimit nr. 762, datë 25.03.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kërkesë shtetasin I. I. - Vendimit nr. 760, datë 25.03.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kërkesë shtetasin B. Sh. - Vendimit nr. 761, datë 25.03.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kërkesë shtetasin Sh. H.		
18	10.04.2025	Gazetar i MCN TV, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 për të drejtën e informimit dëshiroj të njihem me disa informacione në lidhje me ... 1.Sa dosje janë ende stok, të pashqyrtuara nga gjykata e Apelit në total aktualisht? 2.Kryesisht çfarë natyre janë këta dosje, sipas ndarjes së tyre? 3.Sa është koha mesatare e shqyrtimit të një dosje?	18.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 8144 Prot., datë 10.04.2025, ju informojmë se për informacionin e kërkuar mund të referoheni Analizës Vjetore të vitit 2024 të publikuar në faqen e internetit	E plotë	Nuk ka

		4.Cilat janë dosjet që kërkojnë më shumë kohë për tu shqyrtuar? 5.Cfare ka ndikuar që ka nje mbingarkese te ceshtjeve ende te pashqyrtuara?		gjykata.gov.al, bashkëlidhur linkun		
19	10.04.2025	Në kuadër të përgatitjes për një artikull me vlerë,në saj të një provimi akademik,ju lutem te me vini në dispozicion kopjet e vendimeve të listuara më poshtë. Vendimet penale numër 303 dhe 357 te Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem	30.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 8145 Prot., datë 10.04.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale të anonimizuara.	E plotë	Nuk ka
20	10.04.2025	Në kuadër të përgatitjes për një artikull me vlerë,në saj të një provimi akademik,ju lutem te me vini në dispozicion kopjet e vendimeve të listuara më poshtë. Vendimet penale numër 374 dhe 379 te Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem	30.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 8146 Prot., datë 10.04.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale të anonimizuara.	E plotë	Nuk ka
21	10.04.2025	Në kuadër të përgatitjes për një artikull me vlerë,në saj të një provimi akademik,ju lutem te me vini në dispozicion kopjet e vendimeve të listuara më poshtë. Vendimet penale numër 385 dhe 420 te Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem	30.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, derguar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimet penale të anonimizuara.	E plotë	Nuk ka

22	16.04.2025	Ne kuader te transparences publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Per te drejten e informimit”, i ndryshuar, emisioni “V...”, kerkon si informacion: -A ka ardhur ne Gjykatën e Apelit, nga Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Durres (seksioni civil), apelimi i bere nga shtetesia I. P. me objekt “<i>Lëshim autorizimi për shitje</i>”. -A ka ankim pranë Gjykates se Apelit dhe nëse po ne çfarë date eshte regjistruar.	05.05.2025	Në përgjigje të shkresës tuaj dërguar me email me nr. 2516/144 Prot., datë 16.04.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.8712 Prot., datë 16.04.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), nuk rezulton e regjistruar çështja civile në emër të shtetases I. P, me objekt “<i>Lëshim autorizimi për shitje</i>”.	E plotë	Nuk ka
23	08.05.2025	Per nevojat e zbatimit te projektit “Rritja e transparences dhe llogaridhenies mbi buxhetin e sistemit te drejtesise” mbeshetur nga BE dhe zbatuar nga Qendra e Transparences dhe Informimit te Lire (QTIL) 2023-2026, Ju lutem na vini ne dispozicion te materialeve, si me poshte: -Regjistri i realizimeve te prokurimit 2024 -Raporti vjetor i zbatimit dhe monitorimit te buxhetit per vitin 2024.	13.05.2025	Në përgjigje të kërkeses tuaj dërguar me email datë 08.05.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.10657 Prot., datë 09.05.2025, bashkëlidhur ju dërgojmë tabelat e monitorimeve për vitin 2024 dhe Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike për vitin 2024.	E plotë	Nuk ka

24	19.05.2025	Në vijim të korrespondencës sime si gazetarë e pavarur, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj një element kyç juridik: për çështjen e vrasjes së M. Gj, e cila po shqyrtohet aktualisht në apel pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, pas rekursit të paraqitur nga i dënuari K. C. Bëhet fjalë për respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, por edhe për mbrojtjen e të vërtetës gjyqësore në një çështje thellësisht simbolike për shoqërinë shqiptare. Në pritje të një akti të vendosur nga ana juaj, në përputhje me rëndësinë e kësaj çështjeje, ju shpreh mirënjohjen dhe konsideratën më të lartë.	28.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 19.05.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 11330 Prot., datë 19.05.2025, nga verifikimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS, rezultoi e regjistruar çështja penale me numër sistemi, datë 10.09.2024 regjistrimi, nr.3258 akti, me palë ndërgjyqëse: KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë I PANDEHUR: K. C TRASHEGIMTARËT E VIKTIMËS: L. Gj AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me pasojë vdekjen" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 141 dhe 25 të Kodit Penal. Në short elektronik kjo dosje i ka rënë për gjykim relatore gjyqtare Lutfije Celami dhe seanca e radhës për shqyrtimin e çështjes është në datën 05.06.2025, ora 14:00.	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	---------	--------

				Nga sa më sipër, kërkesa juaj i është përcjell gjyqtare relatore znj. Lutfije Celami		
25	21.05.2025	Ne baze te ligjit 119/2014 "Per te Drejten e Informimit", kerkoje nje kopje te vendimit nr...., date 14.04.2025, ne menyre te anomatizuar nga sistemi i kesaj gjykate.Per ceshtje me nr: Theksoj se nuk cenoje asnje te dhene, persa kohe ky vendim do te dergohet i anomatizuar ne respektim te ligjit.	30.05.2025	Ne pergjigje te emailit tuaj date 21.05.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 11591 Prot., datë 21.05.2025, ju bejme me dije se per t’ju vene ne dispozicion vendimin e anonimizuar, duhet te paraqisni kerkesen per informacion sipas formatit te percaktuar, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Formatin e kerkeses per informacion, e gjeni ne faqen e webit te Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem. Bashkelidhur linkun	E plotë	Nuk ka
26	26.05.2025	Si studente e gazetarise dhe komunikimit viti i dyte. Ju lutem te me vini ne dispozicion kopjen e ketij vendimi.	26.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail,në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm bashkëlidhur, ju	E plotë	Nuk ka

		Zgjidhje martese me padites S.Xh, date 17.04.2024		dërgojmë vendimin civil të anonimizuar.		
27	30.05.2025	Ne kuader te transparences publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Per te drejten e informimit”, i ndryshuar, emisioni “V...”, kerkon si informacion: -A ka ardhur dosja e pales I. P nga Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Dures (seksioni civil), me objekt “<i>Lëshim autorizimi për shitje</i>”.	30.05.2025	Në përgjigje të shkresës tuaj dërguar me email me nr. Prot., datë 30.05.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.... Prot., datë 30.05.2025, rezulton e regjistruar çështja civile me numër ... sistemi, datë 07.03.2025 regjistrimi, nr. 666 akti, me palë ndërgjyqëse: KËRKUES: I. P OBJEKTI: Lëshimin e autorizimit për fëmijët e mitur L. K, atësia H dhe amësia I, i datëlindjes 2020 për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 84.83 m2, identifikuar me Nr., Kod unik, Zona Kadastrale ndodhur në Rrugën "...." Durrës. Kjo çështje, është planifikuar për gjykim më datë 16.06.2025, ora 11:00 . Nga verifikimi i kryer në aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se vendimi nr. 18, datë 20.01.2025 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit	E plotë	Nuk ka

				të Përgjithshëm është me kërkues I. P dhe jo në emër të shtetases I. P.Sqarojme gjithashtu se regjistrimi i çështjeve ne sistemin elektronik behet mbi bazën e identitetit te palëve si ato pasqyrohen ne vendimin gjyqësor. Referuar këtij te fundit nuk ka pale me emrin I. P te regjistruar ne sistem, por me emrin I. P.		
28	29.05.2025	Si Gazetar i emisionit investigativ “S..”, po ndjek një investigim lidhur me mënyrën e trajtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në këtë kuadër, ju drejtohem me këtë kërkesë për të më informuar mbi: Datën e regjistrimit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes penale: Me palë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë I pandehur: A. Xh Akuza: "Vjedhja duke shpërdoruar detyrën", parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal Datën e regjistrimit pranë së njëjtës gjykatë të çështjes penale: Me palë: Prokuroria pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë Të pandehur: H Gj etj.	05.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 29.05.2025 e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.12387 Prot., datë 29.05.2025, me të cilën kërkoni informacion lidhur me çështjet penale me të pandehur A. Xh dhe të pandehur H. Gj. Ju informojmë se, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton e regjistruar çështja penale me numër ... sistemi, datë 11.09.2024 regjistrimi, nr.3287 akti, me palë ndërgjyqëse:	E plotë	Nuk ka

		Akuza: "Falsifikimi i dokumenteve në bashkëpunim", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal Lutem të më informoni nëse këto çështje janë regjistruar dhe nëse po, cilat janë datat përkatëse të regjistrimit. Kjo kërkesë vjen në kuadër të transparencës dhe interesit publik për mënyrën e funksionimit të institucioneve të drejtësisë.		KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë TË PANDEHUR: S. Zh, R. L, E. L dhe A. Xh VIKTIMË: Shoqëria Ujsjellës Kanalizime Tiranë" sh.a AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën", e kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 135 e 25 të K.Penal. Në short elektronik kjo dosje i ka rënë për gjykim relator gjyqtar Dritan Hasani dhe seanca e radhës për gjykimin e çështjes është në datën 10.06.2025, ora 12:00. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezultojnë të regjistruar çështja penale me numër ... sistemi, datë 30.09.2024 regjistrimi, nr.3651 akti, me palë ndërgjyqëse: KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	
--	--	---	--	--	--

				TË PANDEHUR: H. Gj, A. K, E. B, J. H, A. H dhe E. M VIKTIMË: I. K AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Mashttrim" të parashikuar nga neni 143/3 dhe 25 i K.Penal dhe për veprën penale "Falsifikim i vulave dhe stampave ose i formularëve", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 190/2 dhe 25 i K.Penal, referuar procedimit penal nr./2020 si dhe për veprën penale "Falsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, në lidhje me procedimin penal nr. ../2019. Në short elektronik kjo dosje i ka rënë për gjykim relatore gjyqtare Brikena Ukperaj dhe deri më datë 03.06.2025 nuk rezulton e planifikuar për gjykim. Në lidhje me sa kërkoni, sipas nenit 426, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: “ 2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim		
--	--	--	--	---	--	--

				çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë". Vetë ligji parashikon mënyrën e nxjerrjes së çështjeve për gjykim, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.		
29	11.06.2025	Emisioni investigative "S...", ka publikuar dhe investiguar rastin e Urdherit të Stomatologut dhe ish-Presidentit të urdherit z. N.D. Kerkoje që të jeme pjesë e gjykimit që do të mbahet me datë 12.06.2025, lidhur me çështjen e Z. N.	11.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 11.06.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 13438 Prot., datë 11.06.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja penale (masë sigurimi), me kërkuar shtetasin me iniciale N. D dhe seanca gjyqësore do të zhvillohet me datë 12.06.2025, ora 09:00. Ju bëjmë me dije se seanca gjyqësore do të zhvillohet me detyrë të mbyllura, për shkak se është në fazë hetimi paraprak.	E plotë	Nuk ka
		Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka ndërmarrë		Ne përgjigje të emailit tuaj dërguar në adresën		

30	16.06.2025	disa vendime fajësie per shtetasit L.B, A. B, bazuar ne ligjin nr. 119 date 18.09.2024, kërkoj nga ana juaj në kuadër të informimit publik, të më vendosni në dispozicion këto vendime për shtetasit e pandehur të ndërmarra nga magjistratët ne Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Lutem që për një kohë sa më të shpejtë të marr një përgjigje pozitive nga ju. Përgjigjen ma adresoni përmes adresës së e-mail, në adresën time elektronike	19.06.2025	sherbime@gjykata.gov.al te gjykates se apelit te juridiksionit te pergjithshem, ju bejme me dije se per t'ju vene ne dispozicion vendimet, duhet te paraqisni kerkesen per informacion sipas formatit te percaktuar, ne perputhje me ligjin nr. 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale". Fromatin e kerkeses per informacion e gjeni ne faqen e webit www.gjykata.gov.al. Bashkelidhur linkun	E plotë	Nuk ka
31	09.07.2025	Si gazetar i emisionit “Xh...”, kërkojë informacion nga institucioni juaj se: 1.Sa eshte vjetersia e dosjeve qe keni ne proces? Cfare i shkakton vonesat e tyre. Cilat jane ceshtjet me te nderlikuara dhe arsyeja?	28.07.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 09.07.2025, regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 16075 Prot., datë 09.07.2025, ju bëjmë me dije se aktualisht janë pa u gjykuar çështje civile dhe penale të regjistruara pranë kësaj gjykate nga viti 2017 e në vijim, bazuar kjo në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë	E plotë	Nuk ka

				30.05.2019 i ndryshuar. Vonesat në gjykimin e çështjeve vijnë për arsye objektive. Rastet e përshpejtimin të çështjeve, janë të përcaktuara në vendimin e sipërcituar të KLGJ-së.		
32	09.07.2025	Si gazetar i emisionit “Xh...”, bazuar mbi ligjin për të drejtën e informimit kërkojë informacion nga institucioni juaj se: -Ne cilin vit ka arritur Gjykata e Apelit me shqyrtimin dhe volumen e çështjeve?	28.07.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 09.07.2025, regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 16074 Prot., datë 09.07.2025, me anë të së cilës kërkonte informacion se "Në cilin vit ka arritur Gjykata e Apelit me shqyrtimin dhe volumen e çështjeve, ju bëjmë me dije se janë pa u gjykuar çështje civile dhe penale të regjistruara pranë kësaj gjykate nga viti 2017 e në vijim, bazuar kjo në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë 30.05.2019 i ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
33	03.07.2025	Te nderuar! Aktualisht, po trajtojmë çështjen e shërbimit të provës në Shqipëri, duke marrë shkas nga vendimi juaj për ish-gjyqtarin Guxim Zenelaj, ku Apeli vendosi ta dënojë këtë të fundit me 100 orë pune në shërbim të komunitetit.	08.08.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 02.07.2025, protokolluar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr.15535 Prot., datë 03.07.2025, nga verifikimi i kryer në kodekset e vendimeve penale pranë Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës së Apelit të	E plotë	Nuk ka

		Në këto kushte, Desada Sadiku dhe Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, në bazë të ligjit Nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Neni 3, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion: 1.Si funksionon shërbimi në komunitet dhe shërbimi ne prove? 2.Sa ka qenë numri i vendimeve për shërbim prove/ në komunitet përgjatë pesë (5) viteve të fundit nga institucioni juaj? 3.Sa prej tyre janë pjesë e sistemit gjyqësor? 4.Sa prej tyre janë pjesë e administratës? Kjo kërkesë bazohet në ligjin të sipërpërmendur, i cili shprehet: “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.”	Juridiksionit të Përgjithshëm rezulton se: Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 17 shtetas, për veprat penale: - “ Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” neni 190 K. Penal - “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal - “Moskallëzim krimi” neni 300 K. Penal - “Veprime që pengojnë zbulimi e të vërtetës” neni 301 K. Penal - “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, neni 278K.Penal - “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike” neni 137/1 K. Penal - “Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal - “Dhuna në familje” neni 130/a K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Durrës, në		
--	--	--	--	--	--

				aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 10 shtetas, për veprat penale: - “<i>Dhuna në familje</i>” neni 130/a K. Penal - “<i>Moskallëzim krimi</i>” neni 300 K. Penal - “<i>Ushtrim i ndikimit të ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>” të kryer në bashkëpunim neni 245/1, paragraf 2 dhe 25 K. Penal - “<i>Fyerja e gjyqtarit</i>” neni 318 K. Penal - “<i>Falsifikimi i dokumenteve</i>” në bashkëpunim neni 186/3 K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 11 shtetas, për veprat penale: - “<i>Prodhimi i kundërligjshëm i mallrave dhe artikujve industrial dhe ushqimorë</i>” neni 288/a/1 K. Penal - “<i>Fshehja e të ardhurave</i>”, neni 180/1 K. Penal		
--	--	--	--	--	--	--

			-“Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” neni 289/1 K. Penal -“Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” neni 178/2 K. Penal -“Ushtrim i ndikimit të ligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” neni 245/1/2 K. Penal -“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike” neni 137/1 K. Penal -“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal -“Plagosje e lehtë me dashje” e kryer në bashkëpunim neni 89, 25 K. Penal -“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, janë dënuar me “punë në interes publik” 6 shtetas, për veprat penale: -“Moskallëzim krimi” neni 300 K. Penal -“Vetëgjyqësi” neni 277 K. Penal		
--	--	--	---	--	--

				-“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” neni 190 K. Penal -“Mbajtja pa leje, prodhimi armëve shpërthyesë dhe municionit” neni 278/2 K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Vlorë, në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, është dënuar me “punë në interes publik” 1 shtetas, për veprën penale: -“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal Për periudhën 01.01.2020 – 31.01.2023, me vendim të Gjykatës së Apelit Korçë nuk është dënuar me “punë në interes publik” asnjë shtetas. Për periudhën 01.02.2023 – 31.12.2024, me vendim të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë dënuar me “punë në interes publik” 22 shtetas, për veprat penale:		
--	--	--	--	---	--	--

				-“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” neni 290/2 K. Penal -“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” neni 291 K. Penal -“Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo të vizave” neni 189/2 K. Penal -“Falsifikimi i dokumenteve” neni 186/2 K. Penal -“Falsifikim i dokumenteve shëndetësore” 188/1 K. Penal -“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 K. Penal -“Mjekim i pakujdesshëm” neni 96/1 K. Penal -“Kundërshtim të punonjësit të policisë” neni 236/2 K. Penal -“Largim nga vendi i aksidentit” neni 273 K. Penal -“Mashttrim ne sigurime ” neni 145 K. Penal -“Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” neni 245/1 K. Penal -“Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” neni 289/1 K. Penal -“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura mbetur në tentativë’ neni 101/2-22 K. Penal		
--	--	--	--	---	--	--

				- <i>“Dhuna në familje” neni 130/a K. Penal</i> Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal janë dënuar me “punë në interes publik”, gjithsej 66 shtetas. Në lidhje me kërkesën tuaj se si funksionon shërbimi në komunitet dhe shërbimi i provës, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk disponon informacion. <i>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.</i>		
34	29.09.2025	Redaksia e emisionit “S...” ka investiguar rastin e E. Gj sipas disa denoncimeve ardhur në redaksinë tonë. Së fundmi duke u nisur nga njoftimi informal se shtetasi H. Gj, ka një proces gjyqësor të caktuar ditën e sotme në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, lind nevoja për të verifikuar dhe sqaruar natyrën e kësaj çështjeje, pozicionin e tij procedural, si dhe përbërjen e trupit gjykues që e shqyrton. Kjo është me rëndësi për të kuptuar: Kërkojmë të na informoni se nëse ai është palë paditëse, palë e paditur, person nën hetim apo në gjykim, apo në një pozitë	02.10.2025	Përshendetje, Në përgjigje të emailit Tuaj, regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 20516 Prot., datë 29.09.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, nuk rezulton e planifikuar për gjykim seancë gjyqësore me datë 29.09.2025, ndaj shtetasit H. Gj. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

		tjetër procedurale, i pandehur apo cfardolloje pozite procedurale. Natyrën e çështjes për të përcaktuar nëse është çështje civile, penale apo administrative, si dhe për të kuptuar objektin konkret që shqyrtohet. Dhe cili Gjyqtar po e gjykon këtë çështje				
35	30.09.2025	Unë e nënshkruara, gazetarë pranë Televizionit K..., në funksion të detyrës dhe bazuar në ligjin Nr. 119/2014 “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”, kërkoj nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, informacion si më poshtë vijon: 1.Sa është organika e plotë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe sa gjyqtarë ka aktualisht në detyrë? 2.Sa është numri total i çështjeve civile dhe penale, që ka të regjistruara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nga cili vit janë? 3.Sa ishte numri i çështjeve të regjistruara në momentin e fillimit të funksionimit të kësaj gjykate? (kur u implementua harta e re gjyqësoreë) 4.Sa është mesatarja e çështjeve që vijnë nga Shkallët e Para në një vit në këtë gjykatë? 5.Sa është mesatarja e çështjeve që ka në shqyrtim një gjyqtar në Gjykatën e Apelit?	03.10.2025	Në përgjigje të emailit Tuaj datë 27.09.2025, regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 20635 Prot., datë 30.09.2025, ju bëjmë më dije se: Në lidhje me pyetjen e parë “Sa është organika e plotë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe sa gjyqtarë ka aktualisht në detyrë?”, ju informojmë se: Në zbatim të vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, Organika e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përbëhet nga 78 gjyqtarë, aktualisht ushtrojnë	E plotë	Nuk ka

		6.Sa është mesatarja e çështjeve që shqyrtohen në ditë në Apel dhe sa salla gjykimi ka në funksion? 7.Sa gjyqtarë janë ngritur në detyrë në këtë gjykatë, që nga momenti i fillimit të funksionimit? 8.Sa gjyqtarë janë larguar?		funksionin pranë kësaj gjykate 32 gjyqtarë. Në lidhje me pyetjen e dytë “<i>Sa është numri total i çështjeve civile dhe penale, që ka të regjistruara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nga cili vit janë?</i>”, ju informojmë se: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, aktualisht janë të regjistruara deri më datë 30.09.2025 afërsisht 45.374 dosje, të cilat janë çështje civile e penale themeli, si dhe kërkesa civile dhe penale, ku rezultojnë çështje të regjistruara në vitin 2017. Në lidhje me pyetjen e tretë “<i>Sa ishte numri i çështjeve të regjistruara në momentin e fillimit të funksionimit të kësaj gjykate? (kur u implementua harta e re gjyqësore)</i>”, ju informojmë se: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë transferuar të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e	
--	--	---	--	---	--

				Apelit Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Gjirokastrë dhe Vlorë të cilat nuk kanë qënë të planifikuara për gjykim deri në datën 31.01.2023, në total janë transferuar 33.731 çështje gjyqësore. Në lidhje me pyetjen e katërt <i>“Sa është mesatarja e çështjeve që vijnë nga Shkallët e Para në një vit në këtë gjykatë?”</i>, ju informojmë se: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë regjistruar për vitin 2023 afërsisht 12.146 dosje, për vitin 2024 afërsisht 13.888 dosje dhe për vitin 2025 deri më datë 30.09.2025 afërsisht 11.468 dosje, të cilat janë çështje civile e penale themeli, si dhe kërkesa civile dhe penale Në lidhje me pyetjet <i>“Sa është mesatarja e çështjeve që ka në shqyrtim një gjyqtar në Gjykatën e Apelit?”</i>, <i>“Sa është mesatarja e çështjeve që shqyrtohen në ditë në Apel dhe sa salla gjykimi ka në funksion?”</i>, <i>“Sa gjyqtarë janë ngritur në detyrë në këtë gjykatë, që nga momenti i fillimit të funksionimit?”</i> dhe <i>“Sa gjyqtarë janë larguar?”</i>, ju informojmë se:		
--	--	--	--	--	--	--

				Për informacionin e kërkuar mund t'i referoheni Analizës Vjetore të vitit 2023 - 2024 të publikuar në faqen e internetit gjykata.gov.al. Bashkëlidhur linkun: https://gjykata.gov.al/media/5623/analiza-per-web.pdf https://gjykata.gov.al/media/4779/analiza-vjetore-2023.pdf Duke ju falënderuar për mirëkuptimin		
36	02.10.2025	Si gazetar pranë emisionit U....., kërkoje vënien në dispozicion nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vendimin penal ndaj shtetasve me initiale V. M etj..	13.10.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me e-mail, protokolluar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 20913 Prot., datë 02.10.2025, bashkëlidhur, ju dërgojmë vendimin penale të anonimizuar për shtetasit V.M etj.	E plotë	Nuk ka
37	24.10.2025	Në kuadër të një studimi, ju lutem kërkoj informacion numrin e “masave të sigurisë” të miratura nga Gjyata e Apelit Tiranë, referuar ankimimeve ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë, për periudhën Janar 2020 deri ne Dhjetor 2024. Informacioni kërkohet i ndarë specifikisht në “masat e sigurisë”: -Arrest me burg (numri total vit pas viti) -Arrest shtëpie (numri total vit pas viti) -Detyrim paraqitje (numri total vit pas viti)	15.12.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 24.10.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 22933 Prot., datë 24.10.2025, me anë të se cilës kërkoni informacion mbi masat e sigurimit të miratuara dhe të ndryshuara nga Gjykata e Apelit, referuar ankimeve të ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave të	E plotë	Nuk ka

		Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje me firmë he vule nga institucioni juaj.		Shkallës së Parë, për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2024, ju informojmë se: Masat e sigurimit të gjykuara për vitin 2020, janë si më poshtë: -Arrest në burg 596 -Arrest në shtëpi 186 -Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 103 Masat e sigurimit të gjykuara për vitin 2021, janë si më poshtë: -Arrest në burg 564 -Arrest në shtëpi 199 -Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 113 Masat e sigurimit të gjykuara për vitin 2022, janë si më poshtë: -Arrest në burg 554 -Arrest në shtëpi 183 -Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 136 Masat e sigurimit të gjykuara për vitin 2023, janë si më poshtë: -Arrest në burg 1165 -Arrest në shtëpi 319 -Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 232		
--	--	---	--	--	--	--

				Masat e sigurimit të gjykuara për vitin 2024, janë si më poshtë: -Arrest në burg 1458 -Arrest në shtëpi 511 -Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore 338		
38	28.10.2025	Rrjeti për Raportimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, po punon për realizimin e një artikulli për pronat e biznesmenit, A. M. Më qëllim realizimin e detyrës por dhe në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, kërkojmë të informohemi dhe të na vihen në dispozicion dokumente në lidhje me këtë çështje. Më konkretisht jemi të interesuar të kemi: 1- Në çfarë faze janë gjykimet ndaj shtetasit A. M? 2- Nëse është marrë një vendim për sekuestrimin e pronave të M, kërkojmë të na vini në dispozicion një kopje të vendimit të sekuestrimit të pasurive. Kjo kërkesë bazohet në ligjin të sipërpërmendur, i cili shprehet: “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.” Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj!	14.11.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 28.10.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 23253 Prot., datë 28.10.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton e regjistruar çështja penale me nr. ...-30-2024-R sistemi, nr. 940 Akti, datë 26.02.2025 regjistrimi, me palë: KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë PALË E INTERESUAR: A. M, A. Xh, A. M. ME OBJEKT: “Vendosja e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" ndaj pasurive në zotërim të shtetasit A. M, A. Xh dhe A. M”.	E plotë	Nuk ka

				Çështja është kthyer për rigjykim me vendimin nr. 00-2024-1907 (288), datë 21.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Aktet janë regjistruar pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 26.02.2025, me gjyqtare relatores Irena Brahimi. Çështja ndodhet në radhën e pritjes për gjykim. Gjithashtu, rezultojnë të regjistruar dhe të gjykuara dy çështje penale me objekt: “Vendosja e mases se sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” ndaj pasurive ne zoterim te shtetasit A. M, A. Xh dhe A. M” dhe “Shuarje e mases se sigurimit pasuror sekuestro preventive”. <i>Bashkëlidhur, vendimet gjyqësore të anonimizuara.</i>		
39	31.10.2025	Si gazetares pranë emisionit F... F...kërkoje informacion në lidhje me çështjen e shtetasës Znj. R. R (Ç) është palë e paditur dhe ankuese në çështjen civile që ka objekt: “Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin	11.11.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 31.10.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 23609	E plotë	Nuk ka

		e kujdestarisë mbifëmijët e mitur”, Në kuadër të investigimit që po kryhet për çshtjen konkrete me respekt kërkoj që Gjykata të na informojë mbi këto çështje: Kohën e saktë të depozitimit të kërkesës ankimore në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe datën e regjistrimit të saj në sistemin gjyqësor; Shkaqet konkrete që kanë penguar deri më sot shqyrtimin ankimit nga ana e kësaj Gjykate; Kohën e pritshme të caktimit për gjykim të çështjes nëfjalë; Numrin total të çështjeve civile të ankimuara që presin shqyrtim para kësaj Gjykate; Numrin e gjyqtarëve të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Apelit Tiranë; Numrin e vendeve ende vakante në këtë trupë gjyqësore.	Prot., datë 31.10.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultoi e regjistruar çështja civile me nr. sistemi, nr. 9183 Akti, datë 24.03.2023 regjistrimi, me palë: PADITËS: K. C E PADITUR: R. C ME OBJEKT: <i>Zgjidhja e martesës dhe lenia e fëmijëve për rritje dhe edukim paditësit.</i> Në short elektronik çështja e mësipërme i ka rënë për gjykim gjyqtare relatores Elona Mihali. Seanca gjyqësore për shqyrtimin e çështjes është caktuar në datën 03.12.2025, ora 12:00. Në lidhje me pyetjen e parë “Kur është bërë ankimi dhe datën e regjistrimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, ju informojmë se: Nga verifikimi në dosjen gjyqësore rezultoi se, kërkesa ankimore është paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier nga pala paditëse K. C më datë		
--	--	--	--	--	--

				06.02.2023 dhe është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm më datë 24.03.2023. Në lidhje me pyetjen e dytë <i>“Shkaqet që kanë penguar deri më sot shqyrtimin e ankimit nga ana e kësaj gjykate”</i>, ju informojmë se: Çështjet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykohen duke ndjekur dhe respektuar radhën e gjykimit datës së regjistrimit të tyre. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë ende në pritje për t’u gjykuar çështjet e regjistruara respektivisht në vitin 2017-2018. Nisur nga këto rrethana, duket qartë se afati dy vjeçar, brenda të cilit duhet të gjykohej një çështje nuk mund të respektohet. Megjithatë, në raste të veçanta kur palët kanë paraqitur kërkesë për përshpejtim dhe gjyqtari relator ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në ligj për pranimin e kërkesës, çështja është gjykuar jashtë radhës. I tillë është edhe rasti konkret, në të cilin gjyqtarja relatore ka pranuar kërkesën e	
--	--	--	--	---	--

			te paditures për përshejtimin e gjykimit. Në lidhje me pyetjen e katërt <i>“Numrin total të çështjeve civile të ankimuara, që presin shqyrtimin pranë kësaj gjykate?”</i>, ju informojmë se: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, aktualisht janë të regjistruara deri më datë 30.09.2025, afërsisht 45.377 dosje në total. Nga këto, 29.460 janë çështje civile dhe 15.915 çështje penale. Në lidhje me pyetjen e pestë dhe të gjashtë <i>“Sa është organika e plotë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe sa gjyqtarë ka aktualisht në detyrë?”</i>, ju informojmë se: Në zbatim të vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor <i>“Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”</i>, Organika e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përbëhet nga 78 gjyqtarë, aktualisht ushtrojnë		
--	--	--	---	--	--

				funksinin pranë kësaj gjykate 32 gjyqtarë. <i>Bashkëlidhur, kopje e vendimit të kërkesës për përshpejtim.</i>		
40	09.12.2025	Ne, redaksia e emisionit investigativ “V....”, bazuar në ankesën e qytetarit Q. A, ju drejtohem përmes kësaj shkresë për të kërkuar informacion lidhur me çështjen civile nr. 1890 Akt, e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë më 29.06.2017 dhe e cila ka përfunduar me vendim më 20.02.2018, me objekt: “Vertetim fakti juridik të njohjes pronës e të asprisë së palujtshme të lënë në trashëgimi nga trashëgimtari N. A me vendndodhje Vlore”, përfshirë pronat me ulla në Furxhi, Qafë e Kociut dhe Bregu i Stefos, gjithsej 75 rrënjë ulla me kufizime përkatëse. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlore i dha të drejtë qytetarit, por është apeluar nga Zyra e Kadastrës Vlorë. Megjithatë, kanë kaluar më shumë se shtatë vite dhe nuk është caktuar ende një datë për zhvillimin e seancës në Apel. Duam të dimë se cila është arsyeja e shtyes së këtij gjyqi në Apel për çështjen e qytetarit Q.A? Informacion mbi datën e mundshme të zhvillimit të gjykimit ose masat që do merren për përshpejtimin e procedurës. Kërkesa ka karakter informues dhe ka për qëllim raportimin e rasteve ku qytetarët	22.12.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 09.12.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 26802 Prot., datë 09.12.2025, ju informojmë se nga verifikimet në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultoi e regjistruar çështja civile me nr. sistemi, nr. 2143 Akti, datë 08.05.2018 regjistrimi, me palë: KËRKUES: Q. A PERSON I TRETË: Këshilli i Bashkisë Vlorë D. A. M. T Qarku Vlorë Z. V. R. P. P Vlorë ME OBJEKT: Vërtetimin e fakti juridik të njohjes pronar të pasurisë së palujtshme të lënë në trashëgimi nga trashëgimlënësi N. A me vendndodhje në Vlorë: "Furxhi", 18 rrënjë ulla, "Qafe e Kociut" 28 rrënjë ulla,	E plotë	Nuk ka

		hasin vonesa të zgjatura në proceset gjyqësore.		"Bregu i Stefos" 29 rrënjë ullinj, gjithësej 75 rrënjë me kufizimet përkatëse. Kjo çështje është rishortuar dhe në shortin elektronik datë 23.04.2025, i ka rënë për gjykim gjyqtare relatores Diamela Goxha dhe deri më datë 18.12.2025 nuk rezultoi e planifikuar për gjykim. Në lidhje me pyetjen e parë "Se cila është arsyeja e shtyes së këtij gjyqi në Apel për çështjen e qytetarit Qemal Agollari?", ju informojmë se: Çështjet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykohen duke ndjekur dhe respektuar radhën e gjykimit datës së regjistrimit të tyre. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë ende në pritje për t'u gjykuar çështjet e regjistruara respektivisht në vitin 2017-2018. Nisur nga këto rrethana, duket qartë se afati dy vjeçar, brenda të cilit duhet të gjykohej një çështje nuk mund të respektohet. Në lidhje me pyetjen e dytë "Informacion mbi datën e mundshme të zhvillimit të gjykimit ose masat që do merren për përshpejtimin e	
--	--	---	--	--	--

				procedurës?", ju informojmë se: Në lidhje me sa kërkon, ju bëjmë me dije se kërkesa për përshpejtim, sipas nenit 460, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: " 2. Relatori cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit./3.Palët mund ti kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanarisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin". Për përshpejtim gjykimi, në bazë të vendimit nr.78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit, në Kreun III "Kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, paraqitja dhe shqyrtim i saj, janë të përcaktuara mënyra e paraqitjes dhe procedimit të kërkesës për përshpejtim gjykimi. Në raste të veçanta kur palët kanë paraqitur kërkesë për		
--	--	--	--	---	--	--

				përshpejtim dhe gjyqtari relator ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në ligj për pranimin e kërkesës, çështja është gjykuar jashtë radhës. Nga sa më sipër, informacioni i kërkuar nga ana juaj i është përcjell gjyqtares relatores znj. Diamela Goxha		
41	12.12.2025	Referuar ligjit nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit, konkretisht neneve 11, 12, 14 dhe 15 të tij, kërkojmë nga ju informacionet e mëposhtme, të cilat nuk bien ndesh me kufizimet e parashikuara nga neni 17/a i këtij ligji. Informacioni do të përdoret për informimin e opinionit publik, pasi çështja mbart interes të lartë. Do të vlerësonim nëse informacioni do të na i vendosni në dispozicion përpara afatit zyrtar' 10 ditore duke e konsideruar me procedurë të përshpejtuar. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj: Kopje të vendimit datë 18.11.2025, me gjyqtare Lutfije Celamin	29.12.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email datë 12.12.2025, e cila është regjistruar pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 27349 Prot., datë 15.12.2025, ju bëjmë me dije se: Vendimi i kërkuar i përket një çështje për caktimin e masës së sigurimit për një proces penal. Për shkak të kësaj natyre gjykata ka detyrimin që të mos komunikojë aktet që i përkasin hetimit paraprak për shkak të sekretit hetimor.	E plotë	Nuk ka

Numrarendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

Data e regjistrimit të kërkesës

Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

Data e kthimit të përgjigjes

Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve të ligjore në fuqi

Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar

Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

